

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN PËR

PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT

1. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i procedurave dhe kompetencave për organizimin, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit administrativ, të paraqitur nga subjekti i inspektimit, kundër vendimit përfundimtar të inspektimit të marrë nga inspektoratet qendrore dhe strukturat e tjera përgjegjëse për inspektimin. Ky projektvendim ka një qasje të re lidhur me trajtimin e masës administrative duke ngritur një komision me përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm, ministritë e linjës, inspektoratet qendrore dhe përfaqësues nga organizata joqeveritare me aktivitet në fushën e biznesit apo nga organet e përfaqësimit të biznesit, për të siguruar pavarësinë e procesit dhe për të rritur besueshmërinë dhe transparencën ndaj subjekteve të inspektimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin dhe shpërbllimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit”, është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2025. Projektvendimi është hartuar në zbatim të përcaktimeve në ligjin nr. 99/2024, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITËSHME

Ky projektvendim synon ngritjen e një komisioni të përbashkët me aktorët e përfshirë në këtë proces, siguron rritjen e transparencës dhe llogaridhëniec në veprimtaritë e inspektimit.

Projektvendimi trajton disa problematika kyçë në sistemin aktual të inspektimit, duke përfshirë:

- a) Shqyrtimin e ankimit për masën administrative të marrë nga trupat inspektuese, të ngritura pranë inspektoratit përkatës, i cili **ka** patur autoritetin e licencimit, programimit dhe inspektimit, gjë e cila mund ta vendos subjektin nën presion administrativ;
- b) Trupa kolegjiale pranë ISH të ngritura në kushtet e konfliktit të interesit;

- c) Mungesa e pavarësisë dhe besueshmërisë nga subjektet e inspektimit tek komisionet e shqyrtimit të ankimit të dënimive dhe masave administrative, të ngritura pranë inspektorateve përkatëse.

Përaprësítë e këtij projektvendimi përfshijnë:

- Krijimin e një procesi transparent dhe të besueshëm për shqyrtimin e ankimit administrativ ndaj masave administrative të marra nga trupat inspektuese, duke shmangur konfliktin e interesit;
- Shqyrtimin e ankimit administrativ në formë transparente, bazuar në prova dhe fakte, nga një trupë kolegjiale e pavarur, ku kemi edhe përfaqësues nga biznesi;
- Forcimi i transparencës dhe llogaridhënieς në veprimtaritë e inspektimit, lidhur me ndryshimin e qasjeve dhe funksionimit në një këndvështrim ndryshtë në riorganizimin, funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës në strukturën e re të inspektimit;
- Mbrojtjen e interesit publik, forcimin e transparencës dhe llogaridhënieς në veprimtaritë e inspektimit;
- Ushtrimin e kompetencave ligjore institucionale pa konflikt interesit, për inspektoratet shtetërore.

Efektet e pritshme të këtij projektvendimi përfshin shtimin e besueshmërisë të subjekteve të inspektimit tek procesi i rregullt i ankimit administrativ, duke ulur për rrjetet online numrin e subjekteve të inspektimit që i drejtohen gjykatës administrative kompetente, shmangien e konfliktit të interesit, forcimi i llogaridhënieς në veprimtaritë e inspektimit.

Të garantojë një proces të digitalizuar ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në sistemin online, duke siguruar që i rregullat dhe procesi i ankimit të jetë i qartë dhe uniform;

IV. VLERËSIMI I LIGJËSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN VENDAS DHE ATË NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i propozuar mbështetet në nenin 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 55, të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Ai harmonizohet me parimet themelore të funksionimit të administratës publike dhe nuk bie ndesh me asnjë dispozitë tjeter ligjore në fuqi.

Gjithashtu, ky projektakt nuk përbën një akt nënligjor që sjell përfitime shtesë për subjektet e përfshira dhe, për pasojë, nuk bie ndesh me dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe vendimin përkatës të Komisionit Qendor të Zgjedhjeve. Ky vlerësim mbështetet në sqarimet e dhëna në shkresën zyrtare të KQZ-së, nr. prot., 1546, datë 03.03.2025, mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, si dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregulator, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (acquis communautaire).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përmban 6 kreu, si më poshtë:

Kreu I, parashikon rregulla për organizimin, funksionimin dhe vendimmarjen e komisionit të shqyrtimit të ankimit, sipas parashikimeve në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, termat e përdorur në këtë vendim, si dhe parimet që rregullojnë këtë vepratari ankimi.

Kreu II, parashikon organizimin, përbërjen dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit, si një strukturë *ad hoc* që ngrihet rast pas rasti pranë Inspektoratit të Përgjithshëm.

Kreu III, parashikon, kompetencat dhe detyrat e komisionit të shqyrtimit të ankimit, sekretariatit teknik me qëllim realizimin e një hetimi administrativ të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Kreu IV, parashikon formën dhe procedurën e ankimit administrativ për subjektet që pretendojnë, se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një vendim përfundimtar në fushën e inspektimit, si dhe e drejta e subjektit për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit.

Kreu V, parashikon, procedurën e shqyrtimit të ankimit si: caktimi i çështjes, shqyrtimi paraprak dhe në themel i ankimit, vendimmarja dhe e drejta për të pasqyruar, vendimi kundër i anëtarit të komisionit, si dhe ndreqjen e gabimeve me anë të një shtojce në rastet kur ka gabime materiale.

Kreu VI, parashikon dispozitat e fundit të cilat kanë të bëjnë me autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

Për zbatimin e projektvendimit ngarkohen Inspektorati i Përgjithshëm, inspektoratet qendrore, strukturat përgjegjëse për inspektimin që janë të organizuara në institucione të tjera, ministritë e linjës, organizatat joqeveritare me aktivitet në fushën e biznesit apo nga organet e përfaqësimit të biznesit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Relacion për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave të hollësishtme për funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit”

Projektakti është hartuar nga Inspektorati Qendror (në proces ristrukturimi si Inspektorati i Përgjithshëm), në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, si dhe është konsultuar paraprakisht me Ministrinë e Drejtësisë.

Ky bashkëpunim është zhvilluar në zbatim të Urdhrit nr. 49, datë 26.03.2025, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit drejtues ndërinstitucional të punës dhe grupeve teknike ndërinstitucionale për riorganizimin dhe ristrukturimin e inspektorateve në Republikën e Shqipërisë, për hartimin e projektakteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit për inspektimin, si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit elektronik të inspektimeve 'e-Inspektimi'".

Projektakti do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vëtëqeverisjen Vendore, në përputhje me kërkesat përkonsultim ndërinstitucional dhe koordinimin e reformës në sistemin e inspektimeve.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

**MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT
DELINA IBRAHIMAJ**